

RRETHANAT ARSIMORE, EKONOMIKE DHE FETARE NË TREVAT
SHQIPTARE GJATË SUNDIMIT OSMAN 1800-1912

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I HISTORISË

NGA

AGON KRASNIQI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI HISTORI

PROGRAMI: HISTORI E KOHËS SË RE

PRISHTINË

KORRIK, 2024

EKSPOZE E TEMËS

Rrethanat arsimore, ekonomike dhe fetare në trevat shqiptare gjatë sundimit osman 1800-1912

Mentori: Prof. Asoc. Dr. Muhamet Qerimi

Kandidati: Agon Krasniqi

Trajtimi i këtij studimi me titull ‘‘Rrethanat arsimore, ekonomike dhe fetare në trevat shqiptare gjatë sundimit osman’’, është i mbështetur në literaturën relevante, revistat shkencore dhe burimet arkivore, me qëllim që të sjellim këndvështrime të reja, që janë një kontribut i rëndësishëm për historiografinë shqiptare. Tema ndahet në tre kapituj:

Kapitulli i parë: trajton aspektin arsimor që ka mbizotëruar në trevat shqiptare gjatë viteve 1800-1912. Fillimisht trajtohet koncepti ideor i arsimit në shtetin osman, zhvillimi i arsimit gjatë viteve 1800-1830, pastaj viteve 1830-1878, 1878-1912, lëvizjen politike xhonturke dhe ndikimi i tyre në aspektin arsimor si dhe përpjekjet për kombëtarizimin e arsimit shqip përmes kongreseve arsimore, si kongresi i Manastirit, Dibrës, Elbasanit, Manastirit të dyte. Me theks të veçantë janë trajtuar statistikat e shkollave të hapura nga osmanët në trevat shqiptare, duke përfshirë mektebet, medresetë, shkollat idadije, rushdiye, iptidaije, etj. Po ashtu është trajtuar politika e fuqive të mëdha për shtrirje të ndikimit në vilajetet shqiptare, me idenë e hapjes së shkollave fetare në vilajetet shqiptare.

Kapitulli i dytë: trajton aspektin ekonomik që ka mbizotëruar në trevat shqiptare gjatë viteve 1800-1912. Fillimisht trajtohet ekonomia osmane në aspektin e përgjithshëm si dhe përpjekjet për një reformë ekonomike. Po ashtu trajtohet aspekti ekonomik gjatë viteve 1800-1912, ku përfshihen statistika të vilajeteve shqiptare për eksportin dhe importin tregtar, aspekti i tregtisë së jashtme dhe të brendshme, provizionizmi, ekonomia agrare, zejtaria, hapja e fabrikave, ekonomia monetare, hapja e degës së bankës osmane në katër vilajetet shqiptare, hapja e bankës Ziraat në sanxhaqet shqiptare, ndikimi i fuqive të mëdha me politikën e imponimit ekonomik, etj.

Kapitulli i tretë: trajton aspektin fetar që ka mbizotëruar në trevat shqiptare gjatë viteve 1800-1912. Fillimisht trajtohet koncepti ideor i fesë në shtetin osman, përkatësia e shkollës juridike islame (Hanefi), sektet fetare. Në anën tjetër trajtohen zhvillimet fetare në vilajetet shqiptare, ku

dhurohen statistika mbi demografinë fetare, sektet fetare (bektashi, rufi, halveti), problemet fetare, etj.